

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java IV 25/03/2015

Java IV TEMA: PROCESI I REGJISTRIMEVE RREGULLUESE

Për matjen e netofitimit mbi bazën e realizimit, përdoret kontabiliteti akrual (i realizimit) në relacion me disa parime dhe koncepte të ndryshme siç janë: periudha kontabël, parimi i të hyrave, parimi i shkakësisë etj.

Kurse për vlerësimin e netofitimit mbi bazën e keshit përdoret kontabiliteti i keshit.

Kontabiliteti akrual (accrual) dhe kontabiliteti i keshit

Termi akrual i referohet situatës në të cilën keshi nuk është arkëtuar ose paguar në emër të hyrave dhe shpenzimeve, por përkundër kësaj të njëjtat duhet të njihen në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

Kontabiliteti akrual i regjistron efektet e të gjitha transaksioneve që ndodhin brenda firmës gjatë një periudhe kontabël.

Ndryshe nga kontabiliteti akrual, në kontabilitetin e keshit regjistrohen vetëm transaksionet që lidhen me arkëtimin dhe pagesat e keshit. Prandaj kontabiliteti i keshit i trajton si të hyra arkëtimet e keshit, kurse si shpenzime trajtohen vetëm pagesat e keshit.

Shembull:

Firma "X" ka blerë një pajisje me vlerë 2,000 € nga firma "Y", me afat pagese 2 muaj.

1. Sipas kontabilitetit aktual ky transaksion do të regjistrohet dhe evidentohet menjëherë në librat e firmës:

Ditari

Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
1	Pajisjet Furnitorët (Ilog e pagueshme) Blerja e pajisjes		2000	2000

Pra regjistrimi do të dukej kështu: debitohet (rritet) llogaria e pajisjeve (pasuri) kurse kreditohet (rritet) llogaria e furnitorëve - Ilog e pagueshme (detyrime apo borxhi).

2. Kurse në kontabilitetin e keshit ky transaksion nuk regjistrohet menjëherë. Sikur ky aparat të ishte paguar menjëherë me kesh atëherë atëherë regjistrimi do të bëhej në anën e debisë të llogarisë së shpenzimeve

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java IV 25/03/2015

Periudha kontabël

Pasqyra e të ardhurave raporton suksesin e biznesit për një periudhë të caktuar kohore. Zakonisht periudha kohore e zakonshme për të cilën përpilohen pasqyrat financiare është një vit. Kjo periudhë kontabël quhet ndryshe edhe periudhë fiskale. Por megjithatë një numër i madh i kompanive i ndërtojnë pasqyrat financiare edhe për periudha më të shkurtra 6 mujore , 3 mujore etj.

Ndërtimi i pasqyrave financiare për periudha të shkurtra kohore implikon domosdoshmërinë e veprimeve rregulluese në fund të çdo periudhe të kontabilitetit.

Parimet e të hyrave

Parimi i realizimit kërkon që të hyrat të njihen dhe regjistrohen në periudhën në të cilën janë përfituar. Njohja e të hyrave pavarësisht nga lloji i ndërmarrjes sipas parimit të realizimit bëhet në momentin e përfitimit të tyre dhe nuk lidhet me arkëtimin e keshit në emër të tyre.

Sipas parimit të shkakësisë shpenzimet krijohen si pasojë e realizimit të të hyrave. Prandaj netofitimi i periudhës kontabël në bazë të këtij parimi duhet të matet duke i kundërvënë të hyrat e realizuara gjatë asaj periudhe me shpenzimet e ndodhura si pasojë e realizimit të atyre të hyrave. Prandaj për këtë arsye veprimet rregulluese në fund të çdo periudhe kontabël janë të nevojshme.

LLOJET E REGJISTRIMEVE RREGULLUESE

1.Shpenzimet e parapaguara

Shpenzimet e parapaguara paraqesin situatën kur keshi paguhet përpara se shpenzimet të kenë ndodhur. Kur ndodhin parapagimet ato regjistrohen si pasuri. Në regjistrimet rregulluese parapagimet si pasuri barten në shpenzime të periudhës për shumën e përdorur të kësaj pasurie.

Shembuj tipik të shpenzimeve të parapaguara janë: parapagimet e sigurimeve, qirasë sepse shpenzimet e tilla paguhen në avans.

Shembull:

Le të supozojmë se firma "Ardi Construction" me 1 nëntor 2014 ka parapaguar për sigurimin e objektit për 12 muajt e ardhshëm në vlerë prej 1,200 €.

Regjistrimi kontabël bëhet:

Ditari

Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
01 nëntor 2014	Parapagimet për sigurime Keshi (paraja e gatshme) Blerja e pajisjes		1,200	1,200

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java IV 25/03/2015

Rregullimet:

Me 31 dhjetor 2014 kur është edhe fundi i periudhës kontabël duhet bërë rregullimet duhet të llogariten se sa është shpenzuar nga ky parapagim

100 € (1/12 e 1,200 €) pra shuma prej 100 € do të duhet të jetë shpenzim mujor për sigurim, dhe me qenë se nga 01 nëntor 2014 deri me 31 dhjetor 2014 janë 2 muaj atëherë për 200 € euro rezulton se është shpenzuar për sigurimin e objektit nga parapagimi kurse në ditar do të regjistrohet si në vijim:

Ditari				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
31/12/2014	Shpenzimet e sigurimeve		200	
	Parapagimet e sigurimeve			200
	Shpenzimet e sigurimeve			

Tani pas bartjes së regjistrimeve rregulluese në librin kryesor saldot korrekte të këtyre llogarive do të duken kështu:

Parapagimet e sigurimeve				Shpenzimet e sigurimeve			
01.10.2014	1,200	31.12.2014	200	31.12.2014	200		
Saldo	1,000			Saldo	200		

Shuma korrekte e cila raportohet në bilancin e gjendjes me datë 31.12.2014 është 1,000€, kurse shuma prej 200 € raportohet si shpenzim i sigurimeve në pasqyrën e të ardhurave të datës 31.12.2014.

2. Të hyrat e shtyera (të pafituara)

Të hyrat e shtyera (të pafituara) paraqesin situatën ku keshi pranohet, kurse të hyrat përfitohen në periudhat e ardhshme, pra keshi pranohet përpara se të hyrat të jenë përfituar ose njohur. Në kohën e ndodhjes të hyrat e shtyera regjistrohen si detyrime, kurse në regjistrimet rregulluese evidencohen si të hyra të periudhës për shumën e shërbimeve të kryera.

Shembull

Kompania "Solid" me datë 01.09.2014 ka dhënë një lokal (depo) me qira te një firmë tjetër për 20 muaj në vlerë prej 8,000 € dhe e cila shumë është derdhur në llogarinë e kompanisë "Solid" po me datën 01.09.2014.

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java IV 25/03/2015

Regjistrimet me 01.09.2014:

Ditari				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
01/09/2014	Keshi (parajae gatshme) Të hyra të shtyera Arketimi i te hyrave para ndodhjes		8000	8000

Të hyrat e shtyera paraqesin një detyrim për ndërmarrjen Solid sepse ajo në 20 muajt e ardhshëm do të ofrojë një objekt afarist në shërbim të qiramarrësit

Rregullimet me 31.12.2014:

Evidentohen të hyrat nga qiraja që kanë kaluar nga data e marrëveshjes apo e pranimit të keshit kurse shuma prej 400 € mujore (8000 €/20 muajt= 400 € për një muaj). Llogaritet për 4 muaj qe kane kaluar nga data e pranimit të keshit 4 muaj x 400 € = 1,600 € pra është shuma që është e hyra nga qiraja

Ditari				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
31/12/2014	Të hyra të shtyera Të hyra nga qiraja Njohja e të hyrave nga qiraja		1600	1600

Tani pas bartjes së regjistrimeve rregulluese në librin kryesor saldot korrekte të këtyre llogarive do të duken kështu:

Të hyra të shtyera				Të hyra nga qiraja			
31.12.2014	1,600	01.09.2014	8,000			31.12.2014	1,600
		Saldo	6,400			Saldo	1,600

3.Shpenzimet rritëse (rrjedhëse)

Shpenzimet të cilat ndodhin ose njihen përpara se keshi të jetë paguar quhen shpenzime rritëse Shpenzimet rritëse (rrjedhëse) kanë të bëjnë me shpenzimet të cilat kanë ndodhur në firmë por të njëjtat nuk janë evidentuar dhe paguar. Në fund të periudhës në veprimet rregulluese këto shpenzime regjistrohen përkundër asaj se të njëjtat paguhen në periudhat e ardhshme.

Shpenzimet rritëse ndryshe quhen edhe shpenzime të paevidentuara; pagat e punëtorëve, shpenzimet e kamatës, shpenzimet publike janë shembuj tipik të shpenzimeve rritëse.

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java IV 25/03/2015

Shembull: Le të supozojmë se firma "Ardi Construction" me 30.12.2014 ka konstatuar se pagat e papaguara ndaj punëtorëve për muajin dhjetor janë në shumë prej 900 €.

Veprimet rregulluese: Rritet llogaria e shpenzimeve të pagave dhe njëkohësisht rriten detyrimet ndaj pagave. Regjistrimet në ditarë:

Ditari				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
31/12/2014	Shpenzimet e pagave Pagat e pagueshme Për pagat e papaguara		900	900

Tani pas bartjes së regjistrimeve rregulluese në librin kryesor saldot korrekte të këtyre llogarive do të duken kështu:

Shpenzimet e pagave			Pagat e pagueshme		
31.12.2014	900			31.12.2014	900
Saldo	900			Saldo	900

4. Të hyrat akruale (rrjedhëse)

Të hyrat të cilat realizohen përpara se keshi të jetë arkëtuar quhen të hyra rritëse (rrjedhëse). Të hyrat akruale (rrjedhëse) janë të hyrat e përfituara gjatë periudhës kontabël, por të njëjtat nuk janë evidentuar dhe se keshi nuk është arkëtuar në emër të tyre. Në regjistrimet rregulluese të hyrat e tilla evidentohen dhe pse keshi në emër të tyre pranohet në periudhat e ardhshme. Shembuj tipik të të hyrave rritëse janë të hyrat nga kamata dhe qiraja.

Shembull

Le të supozojmë se ndërmarrja "Solid" me 31.12.2014 ka vlerësuar se të hyrat e paarkëtuara nga qiraja për muajin dhjetor janë 200 €.

Regjistrimet rregulluese:

Rritet llogaria "kamatat e arkëtueshme" dhe po ashtu rritet llogaria "të hyrat nga qiraja" si në vijim:

Ditari				
Data	Emri i llogarisë dhe përshkrimi	Ref	Debi	Kredi
31/12/2014	Qiraja e arkëtueshme Të hyrat nga qiraja Për të hyrat e paarkëtuara nga qiraja		200	200

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java IV 25/03/2015

Pas bartjes së regjistrimeve rregulluese në librin kryesor saldot korrekte të këtyre llogarive do të duken kështu:

Qiraja e arkëtueshme		Të hyrat nga qiraja	
31.12.2014	200		31.12.2014 200
Saldo	200		Saldo 200

Ushtrime:

Të dhënat e paraqitura në bilancin vertëtues në vazhdim janë saldot (gjendjet) e llogarive të ndërmarrjes "X",

Bilanci vertëtues 31.12.2014

Emertimi i llogarive	Debi	Credi
Ndertesat	120,000	
Pajisjet	50,000	
Parapagimet e qirase	3,000	
Llogarite e arketueshme	4,000	
Parapagimet e sigurimeve	5,000	
Keshi	7,000	
Furnizimet për zyre	1,000	
Zhvlerësimi i akumuluar		8,000
Kapitali i pronarit		152,000
Tërheqjet e pronarit	2,000	
Llogaritë e pagueshme		8,000
Të hyra të shtyera		10,000
Pagat e pagueshme		2,000
Të hyrat nga shitjet		30,000
Shpenzimet e pagave	5,000	
Shpenzimet e qirasë	7,000	
Shpenzimet e shërbimeve publike	5,000	
Shpenzimet e sigurimeve	1,000	
Totali	210,000	210,000

Të dhënat e nevojshme

- 1) Zhvlerësimi i ndërtesave dhe i pajisjeve është 6000 euro

- 2) Furnizimet e paharxhuara në fund të vitit janë 500 eur
- 3) Në emër të parapagimeve të sigurimeve janë njohur si shpenzime të sigurimit 3000 euro
- 4) Pagat e përfituara, por të papaguara janë në vlerë prej 1000 euro
- 5) Në emër të të hyrave të shtyera janë kryer shërbime në vlerë prej 8000 euro
- 6) Në emër të parapagimeve të qirasë për këtë vit janë njohur shpenzimet në vlerë prej 1000 euro

Kërkohet

- 1) Të hapen llogaritë nga bilanci vërtetues i parregulluar
- 2) Të regjistrohen në ditar veprimet e nevojshme rregulluese dhe të njëjtat të barten në librin kryesor
- 3) Përpilimi i bilancit vërtetues me rregullime
- 4) Përgatitja e pasqyrës së të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit të pronarit dhe bilancin e gjendjes.